



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

SH P A L L J E

Për pozicion me kontratë shërbimi

Instituti i Statistikave (INSTAT) shpall pozicion pune për "Anketues" me kontratë shërbimi.
Detajet dhe kërkesat për aplikim janë si më poshtë:

Pozicioni: 10 (dhjetë) Anketues terreni

Afati aplikimit: 07 Korrik 2026.

Bashkia: Në 10 Njësi Administrative (Fshatra) sipas shpërnadrjes bashkëlidhur.

Periudha e kontraktimit: 10 ditë pune (5 ditë trajnim dhe 5 ditë punë në terren).

Trajnimi zgjat 5 ditë dhe është i detyrueshëm.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Kërkesë, ku të specifikohet pozicioni i kërkuar;
- CV ;
- Kopje e dokumentit të identifikimit (ID);
- Kopje e diplomës (arsimi i lartë ose i mesëm).

Detyrat kryesore të anketuesit:

1. Të respektojë dhe zbatojë rigorozisht parimet e statistikave zyrtare.
2. Të njohë shumë mirë përmbajtjen e pyetësorit, koncepteve dhe terminologjisë së përdorur në anketë.
3. Të përgatisë dhe planifikojë intervistat sipas një plani të studiuar dhe dakordësuar me drejtuesit që menaxhojnë procesin e mbledhjes së të dhënave në terren.
4. Të plotësojë pyetësorin në tabletin e marrë në dorëzim dhe listat paraprake të zonave të anketimit, në përputhje me kushtet dhe rregullat teknike të përgatitura nga INSTAT.
5. Të kryejë dhe të drejtojë personalisht intervistat me njësisë statistikore të caktuar për intervistim.
6. Të njohë dhe të respektojë formatet e kontrollit dhe përdorimin e tyre, raportimin ditor tek specialistët e zyrës statistikore me qëllim vlerësimin e progresit të anketës për çdo pyetësor të nominuar.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

7. Të raportojë dhe të dërgojë të dhënat në INSTAT sipas një kalendari të miratuar paraprakisht nga personi përgjegjës i anketës.
8. Të kontaktojë specialistin përgjegjës për kryerjen e anketës në INSTAT, për sqarime rreth paqartësive që mund të ketë në lidhje me punën.
9. Të informojë njësitë statistikore që janë pjesë e vrojtimit për qëllimin e anketës dhe të shpjegojë që të dhënat e mbledhura do të përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe studimore, si dhe të nënvizojë faktin që anketa është konfidenciale.
10. Gjatë punës në terren të respektojë dhe zbatojë rregullat e etikës dhe pavarësinë profesionale.
11. Respekton etikën profesionale dhe kodin e sjelljes në marrëdhëniet me kolegët dhe me të intervistuarit.

Kualifikimet:

- Të kenë përfunduar minimalisht arsimin e mesëm;
- Preferohet të jenë studentë në nivelin bachelor ose të kenë përfunduar së paku ciklin e parë të studimeve universitare;
- Të kenë përvojë në përdorimin e teknologjisë së informacionit, në veçanti përdorimin e pajisjeve si laptopë dhe/ose tabletë;
- Preferohet të kenë përvojë të mëparshme në realizimin e anketave apo intervistimeve të ngjashme në terren.

Aftësi të kërkuara:

- Komunikim dhe bashkëpunim efektiv në grup;
- Gatishmëri për të punuar në grup dhe për të ndjekur udhëzimet e ekipit drejtues;
- Preferohet të kenë aftësi për orientim në terren dhe përdorim të hartave për identifikimin e vendbanimeve;
- Të jenë të gatshëm për të përballuar kushtet atmosferike duke pasur parasysh që puna kryhet në terren dhe mund të kërkojë ecje të gjata.

Mënyra e aplikimit: *nëpërmjet postës zyrtare, pranë Institutit të Statistikave (INSTAT) ose nëpërmjet email-it në adresën: rekrutime@instat.gov.al*

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Tabela e shpërndarjes.

Numri i anketuesve	Bashkia	Njësia Administrative	Fshati
1 Anketues	MALIQ	PIRG	Zvirinë
1 Anketues	PËRMET	PETRAN	Qilarishtë Qilarisht i Vogël Badilonjë Leshnicë
1 Anketues	BELSH	FIERZË	Hardhi Çërragë
1 Anketues	PUKË	GJEGJAN	Gojan i Vogël Gjegjan
1 Anketues	DIVJAKË	TËRBUF	Çermë e Sipërme
1 Anketues	SELENICË	KOTE	Mavrovë Hysoverdhë Kotë
1 Anketues	DURRËS	ISHËM	Gjuriçaj
3 Anketues	FIER	LIBOFSHË	Libofshë Frreth-Libofshë
	Fier	Bashkia Fier	
	FIER	FRATAR	Behaj

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vllazën Huta" Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al